



Republika e Shqipërisë



Republika e Kosovës



**PAKETA E DOKUMENTEVE MBI PROCEDURAT  
E ZHVILLIMIT TË KONKURSIT TË TEKSTEVE  
MËSIMORE PËR DIASPORËN**

---

**KOMISIONI I PËRBASHKËT SHQIPËRI-KOSOVË  
PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE  
PËR DIASPORËN**

**2021**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRI I SHTETIT  
PËR DIASPORËN

MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 762 Prot.

Nr. 915 Prot.

Nr. 234 Prot.

Tiranë, më 9.02.2021

Tiranë, më 9.02.2021

Prishtinë, më 16.02.2021

## PAKETA E DOKUMENTEVE MBI PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË KONKURISIT TË TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN

MIRATOHET

EVIS KUSHI

MINISTËR



MIRATOHET

RAMË LIKAJ

MINISTËR



MIRATOHET

PANDELI MAJKO

MINISTËR



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA DEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE ARCHIVE SECTOR			
Njesia Org.	01/B	Nr. Prot:	
Org. Jedinica		Broj Prot:	234
Org. Unit		Prot. No.	
Nr. i faqeve		Data:	16.02.21
Br. stranica		Date:	
No. pages			
Prishtinë / a			

Tiranë, Prishtinë, shkurt 2021

## **PËRMBAJTJA**

---

- 1. Standardet për tekstet mësimore të mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë**
- 2. Paketa e dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën**
- 3. Kriteret për përzgjedhjen e recensuesve**





**STANDARDET PËR TEKSTET MËSIMORE TË MËSIMIT  
PLOTËSUES TË GJUHËS SHQIPE DHE TË KULTURËS  
SHQIPTARE NË DIASPORË DHE NË MËRGATË**



Prishtinë – Tiranë, 2020

## **Grupi i punës**

Dokumenti “Kurrikula e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë” u hartua nga:

- **Shqipe Gashi**, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (MASH), Republika e Kosovës;
- **Arbër Salihu**, MASH, Republika e Kosovës;
- **Feime Llapashtica**, MASH, Republika e Kosovës;
- **Isni Kryeziu**, MASH, Republika e Kosovës;
- **Ymer Avdiu**, Ministria e Punëve të Jashtme, Republika e Kosovës;
- **Anila Ferizaj**, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Republika e Shqipërisë;
- **Erida Koleci**, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), Republika e Shqipërisë;
- **Evis Mastori**, ASCAP, Republika e Shqipërisë.
- **Mimoza Hysa Çuliqi**, Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD), Republika e Shqipërisë.

## **Hyrje**

Konteksti i ri politik e arsimor me unifikimin e kurrikulës së mësimi plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe në mërgatë ka shfaqur nevojën edhe për unifikimin e standardeve të teksteve mësimore për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe në mërgatë.

Standardet e teksteve mësimore të mësimi plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare të Diasporës janë bazuar në Standardet për Tekstet Shkollore të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë (2011, 2015).

Përshtatja, hartimi dhe miratimi e këtyre standardeve për tekstet mësimore të mësimi plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë (në vazhdim tekstet mësimore për Diasporën) u bë nga Komisioni i Përbashkët për Miratimin e Teksteve Mësimore në Diasporë që funksionon me Vendim nr. 4, datë 13.10.2020, të *“Për hartimin dhe miratimin e standardeve, për tekstet mësimore të mësimi plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë dhe në mërgatë në përputhje me legjislacionet e të dyja vendeve”*, në konsultim me shoqatat e mësuesve të mësimi plotësues të Diasporës dhe mërgatës.

## **Qëllimi dhe funksionet e standardeve**

Ky dokument u drejtohet specialistëve të arsimit, mësuesve, shtëpive botuese, autorëve të teksteve mësimore, recensuesve dhe komisioneve për miratimin e teksteve mësimore për mësimin plotësues të Diasporës dhe mërgatës.

Qëllimi i këtyre standardeve është që ato të përdoren si udhëzues dhe instrument për hartimin dhe vlerësimin e teksteve mësimore të mësimi plotësues për Diasporën, bazuar në tregues të matshëm.

Standardet janë në funksion të përpunimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të teksteve mësimore ekzistuese ose/dhe për krijimin e teksteve të reja, gjithnjë

në funksion të përmbushjes së qëllimeve dhe kërkesave të kurrikulës së mësimi plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë.

## **STANDARDET, TREGUESIT DHE LLOGARITJA E TYRE**

### **Standardet**

Standardet për tekstet mësimore për Diasporën janë të ndara në pesë aspekte dhe të gjitha kanë peshën dhe rëndësinë e njëjtë.

- 1) Përputhshmëria me kurrikulën, formatimi, paraqitja.
- 2) Aspekte shkencore dhe didaktike.
- 3) Integrimi dhe heterogjeniteti.
- 4) Aspekte pedagogjike.
- 5) Aspekte të praktikës mësimore.



## TREGUESIT E STANDARDEVE DHE LLOGARITJA E TYRE

Për secilin standard janë përcaktuar treguesit, përmes të cilëve mund të gjykohet se deri në ç'masë është përmbushur ai (standardi). Ndërsa masat e përmbushjes së treguesve vlerësohen me numrat nga 0 deri në 4 që kanë këtë domethënie (vlerë):

**0= Nuk përmbushen** - kërkesat e treguesit në fjalë nuk janë përfillur fare në tekstin mësimor.

**1= Përmbushen pjesërisht** - disa nga kërkesat e treguesit janë përfillur, por mund të konsiderohet që teksti mësimor nuk i përmbush sa e si duhet ato.

**2= Përmbushen mjaftueshëm** - vetëm disa prej kërkesave të treguesit përkatës përmbushen në tekstin mësimor, por ende jo mirë.

**3= Përmbushen mirë** - kërkesat e treguesit përkatës janë përmbushur mirë në tekstin mësimor, por disa përmirësime janë të mundshme.

**4= Përmbushen shumë mirë** - kërkesat e treguesit përkatës janë përmbushur shumë mirë në tekstin mësimor.

Vlera e secilit standard mund të llogaritet përmes formulës si në shembullin e tabelës.

## Shembull

### Standardi 1: Përputhshmëria me kurrikulën

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
1.1	Teksti mësimor përputhet me qëllimet dhe parimet e kurrikulës së mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë dhe në mërgatë.				X	
1.2	Teksti mësimor përputhet me parimet dhe me kërkesat e fushave kurrikulare të nivelit për të cilin është përgatitur.			X		
1.3	Teksti mësimor përshtatet me konceptimin e teksteve të dy niveleve të tjera. Ai ruan vazhdimësinë e kurrikulës së mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë dhe në mërgatë (duke respektuar trajtimin dhe thellimin e disa aspekteve në nivele më komplekse).					X
<b>Shuma e vlerave të tregueseve (1.1 + 1.2 + 1.3) = 3 + 2 + 4 = 9</b>						
<b>Vlera e standardit 1 = 9 : 3 = 3 (i përmbushur mirë)</b>						

Llogaritja e vlerës së tekstit mësimor në tërësi bëhet duke gjetur mesataren aritmetike të vlerave të të gjitha standardeve. (shih formularin përmbledhës/vlera e tekstit, në fund të materialit/ dokumentit)

## KALUESHMËRIA E TEKSTIT

Bazë për kalueshmërinë e tekstit mësimor duhet të jetë vlera minimale 3 (i përmbushur mirë) për secilin standard dhe vlera 2 (i përmbushur mjaftueshëm) për çdo tregues. Edhe në qoftë se vlera mesatare e përgjithshme (e të gjithë standardeve) është mbi 3, recensuesi duhet të tregojë me shkrim të detajuar, që treguesit e vlerësuar me vlerën 0 ose 1 të përpunohen në mënyrë që teksti mësimor të fitojë lejen e botimit.



## **STANDARDET SIPAS ASPEKTEVE**

## I. PËRPUTHSHMËRIA ME KURRIKULËN, FORMATIMI, PARAQITJA (STANDARDET 1-3)

### STANDARDI 1: PËRPUTHSHMËRIA ME KURRIKULËN

**Synimi:** *Teksti mësimor të përputhet me parimet dhe me qëllimet e kurrikulës së mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë, me rezultatet e të nxënit sipas niveleve, tematikave dhe temave për lëndë mësimore, duke garantuar integrimin, vazhdimësinë dhe koherencën midis tyre.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
1.1	Teksti mësimor përputhet me qëllimet dhe parimet e kurrikulës së mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë dhe në mërgatë.					
1.2	Teksti mësimor përputhet me rezultatet e të nxënit sipas niveleve, tematikave dhe temave për lëndë mësimore					
1.3	Teksti mësimor e ruan integrimin dhe koherencën e tematikave dhe temave të lëndëve mësimore ndërmjet niveleve, përshtatet me konceptimin e teksteve të dy niveleve të tjera. Ai ruan vazhdimësinë e kurrikulës së mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë dhe në mërgatë (duke respektuar trajtimin dhe thellimin e disa aspekteve në nivele më komplekse).					

**Vlera e standardit 1 = {[1.1 + <sup>-1</sup> + 1.3] : 3} =**

<sup>1</sup> Viza ka kuptimin deri (p.sh nga 1.1 deri në 1.3)

## STANDARDI 2: PARAQITJA DHE QARTËSIA

**Synimi:** *Teksti mësimor të ketë faqosje të pëlqyeshme dhe strukturë të qartë, dhe të ndihmojë orientimin e shpejtë në të.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
2.1	Teksti mësimor ka paraqitje të jashtme dhe të brendshme aktuale dhe tërheqëse (sa u takon kopertinës, kompozimit të faqes, koherencës së konceptimit grafik me faqosjen, madhësisë së germave dhe largësisë mes rreshtave).					
2.2	Teksti mësimor, në tërësi ka strukturë të qartë që lejon orientim të shpejtë dhe të lehtë (p.sh., përmes pasqyrës së përmbajtjes së tekstit, përmes simboleve orientuese etj.).					
2.3	Teksti mësimor mundëson orientimin në secilën faqe në mënyrë të përshtatshme për moshën e nxënësve; elementet dhe mjetet grafike (përfshirë simbole dhe piktograme që ndihmojnë në orientim) si dhe ilustrimet përdoren në mënyrën e duhur.					
2.4	Burimet e teksteve të marra nga veprat e tjera janë dhënë me korrektësi.					

**Vlera e standardit 2 =  $\{[2.1 + - + 2.4] : 4\} =$**

### STANDARDI 3: ILUSTRIMET

**Synimi:** *Ilustrimet (fotografi, vizatime, piktura, diagrame, tabela, grafikë, komente të shkurtra shpjeguese) të jenë të kuptueshme, krijuese dhe plotësuese dhe të nxitin vetëveprimin e nxënësit.*

*Cilësia e ilustrimeve të jetë e lartë nga pikëpamja estetike, dokumentare dhe shpjeguese.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
3.1	Ilustrimet (fotografi, vizatime, piktura, piktograme, harta, diagrame, tabela, grafikë etj.) plotësojnë shkrimet e tekstit.					
3.2	Ilustrimet kanë cilësi të lartë nga pikëpamja estetike, dokumentare apo shpjeguese.					
3.3	Ilustrimet janë të kuptueshme, të larmishme dhe përputhen me përmbajtjen mësimore.					
3.4	Ilustrimet janë të mjaftueshme për njësitë/temat mësimore.					

**Vlera e standardit 3 = {[3.1 + - + 3.4] : 4} =**

**II. ASPEKTET SHKENCORE DHE DIDAKTIKE  
(Standardet 4-8)**

**STANDARDI 4: CILËSIA, RËNDËSIA DHE AKTUALITETI NË  
PIKËPAMJE PËRMBAJTËSORE DHE SHKENCORE**

**Synimi:** *Përmbajtja shkencore, shtjellimi didaktik dhe metodik i përmbajtjeve mësimore (përkatësisht, kombinimet shkrime-illustrime) dhe situatat/ përvojat e paraqitura në tekstin mësimor të jenë të sakta, aktuale dhe të rëndësishme për tematikat/temat e trajtuara.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
4.1	Shkrimet në tekstin mësimor kanë përmbajtje me saktësi shkencore, vlerë arsimore dhe edukative dhe janë në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme dhe të nesërme.					
4.2	Nga pikëpamja shkencore, shkrimet e zgjedhura në tekstin mësimor janë korrekte, të rëndësishme dhe të përshtatshme për tematikën dhe temat e trajtuara.					
4.3	Shkrimet në tekstin mësimor, mënyrat metodike të trajtimit të tyre, si dhe tipat e ushtrimeve, detyrave dhe pyetjeve të zgjedhura janë në përputhje me arritjet në shkencë dhe në didaktikë.					
4.4	Teksti mësimor kontribuon në arritjen sistematike të rezultateve të nxënies për nivele, tematika/tema të përcaktuara me kurrikulë.					

**Vlera e standardit 4 = {[4.1 + - + 4.4] : 4} =**

## STANDARDI 5: PËRSHTATJA ME MOSHËN E NXËNËSVE

**Synimi:** *Përmbajtjet e tekstit mësimor, pamja, niveli i vështirësisë, faqosja dhe elemente të tjera të ngjashme me këto, të përshtaten me moshën e nxënësve, për të cilët ai është konceptuar. Teksti mësimor të jetë i kuptueshëm, i vlefshëm nga ana mësimore - edukative dhe tërheqës për grup-moshën në fjalë.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
5.1	Përmbajtjet mësimore të trajtuara në tekstin mësimor përputhen mirë me mundësitë njohëse dhe përvetësuese të grup-moshës në fjalë.					
5.2	Përmbajtjet në tekstin mësimor (kombinimet shkrim-ilustrim) janë në përputhje me përvojat, kërkesat, rrethanat e jetës së grup-moshës përkatëse të nxënësve, duke marrë parasysh heterogjenitetin përvojave dhe interesave të tyre.					
5.3	Elementet grafike të tekstit mësimor (fotografitë, grafikët, hartat etj.) përputhen me karakteristikat e grup-moshës së nxënësve dhe janë të kapshme e tërheqëse për ata.					
5.4	Paraqitja e jashtme dhe e brendshme (formati, faqosja, madhësia e shkronjave, largësia midis rreshtave etj.) i përshtaten grup-moshës së nxënësve.					

**Vlera e standardit 5 = {[5.1 + - + 5.4] : 4} =**



## STANDARDI 6: KONCEPTIMI DHE SHTJELLIMI DIDAKTIK

**Synimi:** Teksti mësimor të ketë konceptim didaktik bashkëkohor që konkretizon kërkesat e qasjeve të reja. Përgatitja, hartimi dhe shtjellimi i njësive/temave mësimore, i situatave të nxënies (ushtrime, detyra etj.) dhe i udhëzimeve të mbështeten në parimet didaktike aktuale, si: të nxënies në mënyrë të pavarur, bashkëpunimi në grup, të nxënies ndërveprues, gjithëpërfshirës dhe reflektues etj. Teksti mësimor të ofrojë situata, materiale dhe sugjerime të përshtatshme për nivele dhe stile të ndryshme të nxënies së nxënësve.

**Shënim.** Struktura e kuptueshme e tekstit mësimor dhe orientimet e qarta për qëllimet dhe për rezultatet e të nxënies ndihmojnë dhe prindërit të kuptojnë më mirë çka ndodh dhe çka kërkohet në procesin e të nxënies, që dhe ata të jenë në gjendje t'i ndihmojnë më lehtë fëmijët e tyre.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
6.1	Teksti mësimor është ndërtuar sipas një konceptimi didaktik të qartë dhe koherent të cilin e respekton me përpikëri.					
6.2	Në tekstin mësimor, temat dhe situatat e të nxënies (shkrimet, detyrat, ushtrimet etj.) janë renditur nga e thjeshta te më e ndërlikuara.					
6.3	Përmbajtja e tekstit mësimor është ndarë në njësi dhe në hapa pune të përshtatshëm, të qartë e të kuptueshëm për nxënësit.					
6.4	Teksti mësimor ofron situata të nxënies, detyra, ushtrime dhe sugjerime të qarta që ndihmojnë nxënësit të orientohen me lehtësi, të vendosin synime dhe të vlerësojnë suksesin e arritjeve.					
6.5	Teksti mësimor, përmes ilustrimeve, grafikëve, shpjegimeve të fjalëve, formulimeve, termave e koncepteve të reja, konkretizon dhe mbështet të nxënies.					

6.6	Për secilën temë, teksti mësimor përmban shkrime, materiale, ushtrime dhe detyra në nivele të ndryshme, të kërkesave dhe vështirësisë, të cilat i motivojnë nxënësit në procesin e përvetësimit dhe të transferimit të njohurive.					
6.7	Përmes materialeve dhe udhëzimeve të përshtatshme, teksti mësimor nxit të nxënësit në mënyrë të pavarur si dhe mundëson diferencimin e brendshëm në klasat heterogjene dhe me nivele arsimore të ndryshme.					
6.8	Teksti mësimor ofron mënyra, strategji dhe teknika për zhvillimin e aftësive metakognitive që lidhen me procesin e të nxënësit.					
6.9	Teksti mësimor nxit mendimin kritik dhe krijues të nxënësve, si dhe zhvillon aftësitë e tyre për të zgjidhur probleme dhe për të marrë vendime të argumentuara.					
6.10	Teksti mësimor ofron tema, shkrime, ushtrime etj. që janë të përshtatshme për të punuar në forma të ndryshme sociale bashkëpunuese, komunikuese dhe ndërvepruese (p.sh.: mësim me të gjithë klasën, punë në çifte, punë në grupe).					
6.11	Teksti mësimor përmban materiale, sugjerime, detyra etj., të cilat lejojnë shtjellime të temave, sipas nevojave dhe niveleve të ndryshme të nxënies.					
6.12	Teksti mësimor u shpjegon dhe u qartëson nxënësve qëllimet, kërkesat, rrugët/mënyrat dhe rezultatet e të nxënësit, çka ndihmon të orientohen vetë, të kenë parasysh qëllimet dhe të aftësohen të vetëvlerësojnë rezultatet e nxënies.					

**Vlera e standardit 6 = {[6.1 + - + 6.12] : 12} =**

## STANDARDI 7: PYETJET DHE UDHËZIMET PËR DETYRAT

**Synimi:** *Pyetjet dhe detyrat e paraqitura në tekst, përveç njohurive, të nxisin edhe zhvillimin e shkathtësive, të qëndrimeve dhe vlerave. Pyetjet të jenë të formuluar thjesht, qartë, shkurt dhe saktë; të jenë të hapura, të nxitin krijimtarinë, që nxënësit të jenë aktivë në procesin e të nxënësve dhe të mund të arrijnë në përfundime të pavarura.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
7.1	Pyetjet janë hartuar për nivele të ndryshme njohëse dhe bazohen në situatat që paraqiten në tekst.					
7.2	Pyetjet, në aspektin metodologjik, janë të hartuara që t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë krijimtarinë e tyre.					
7.3	Formulimi i pyetjeve dhe i detyrave i ndihmon nxënësit të zhvillojnë të menduarit kritik dhe të pavarur.					
7.4	Paraqitja e detyrave në tekstin mësimor nxit nxënësit të hulumtojnë vetë dhe të gjejnë burime të ndryshme të informacionit.					
7.5	Detyrat e përzgjedhura në tekstin mësimor i japin përparësi punës në grup të nxënësve dhe zhvillojnë kompetencat gjuhësore.					
7.6	Pyetjet dhe detyrat në tekst janë në përputhje me përmbajtjen e tekstit mësimor, të kuptueshme nga nxënësit dhe të përshtatshme për moshën e tyre.					

**Vlera e standardit 7 = {[7.1 + - + 7.6]: 6} =**

## STANDARDI 8: ASPEKTET GJUHËSORE

**Synimi:** *Gjuha e tekstit mësimor të jetë në përputhje me normat e gjuhës standarde dhe t'u shërbejë nxënësve si shembull. Aspektet leksikore, morfologjike dhe sintaksore, gjatësia e shkrimeve mësimore (për njësi mësimore), t'u përshtatet aftësive gjuhësore të moshës për të cilën teksti mësimor është përgatitur. Formulimet, sidomos të udhëzimeve, të pyetjeve dhe të detyrave, të jenë të kuptueshme dhe të thjeshta, që të nxitet të nxënët e pavarur të nxënësve. Për të njëjtën temë, teksti të ofrojë shkrime dhe materiale me nivele gjuhësore të ndryshme, duke ndihmuar dhe duke nxitur me këtë të gjithë nxënësit.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
8.1	Leksiku i përdorur përputhet me moshën e nxënësve, çka e bën gjuhën e tekstit të kuptueshme për ta.					
8.2	Ndërtimi sintaksor dhe gjuha e shkrimeve të tekstit mësimor përputhen me mundësitë gjuhësore të nxënësve për të cilët është përgatitur teksti.					
8.3	Gjatësia e shkrimeve u përshtatet moshës dhe aftësive të leximit të nxënësve.					
8.4	Formulimet, sidomos të detyrave dhe të udhëzimeve për punë të pavarur, janë të kuptueshme dhe të thjeshta, që nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur.					
8.5	Gjuha e tekstit mësimor, në aspektet morfologjike, sintaksore dhe drejtshkrimore, përputhet plotësisht me normat e standardit të gjuhës.					

**Vlera e standardit 8 = {[8.1 + - + 8.5] : 5} =**

### III. ASPEKTE TË INTEGRIMIT DHE HETEROGJENITETIT

#### STANDARDI 9: INTEGRIMI DHE HETEROGJENITETI

**Synimi:** Teksti mësimor të jetë në funksion të mësimdhënies së integruar dhe heterogjenitetit të mësimit plotësues. Gjithashtu të kontribuojë në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar, integrimin në shoqërinë vendore dhe të origjinës.

**Shënim.** Heterogjeniteti i organizimit të mësimit plotësues në gjuhën shqipe (sipas shteteve, njësive brenda shteteve dhe bartësve të tjerë të organizimit), puna dhe kërkesat e kurikulës së tipit të integruar, prezenca e moshave të ndryshme, kryesisht në klasa të bashkuara (të kombinuara), interesat e tjera të nxënësve, të prindërve dhe të shoqërisë, ndryshueshmëria e kompetencave paraprahe të nxënësve në fusha të caktuara, baza profesionale-kualifikuese e mësuesve etj. janë faktorë që duhen marrë në konsideratë gjatë hartimit dhe vlerësimit të teksteve mësimore për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare për diasporën. Vetë natyra e punës dhe kërkesat e kurikulës së integruar kërkojnë edhe tekste mësimore të tipit të integruar, që përfshijnë gjuhën shqipe, historinë, gjeografinë, kulturën muzikore dhe kulturën figurative.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
9.1.	Teksti mësimor integron lëndët/përmbajtjet mësimore në tematika dhe tema. siç janë konceptuar në kurikulën e mësimit plotësues.					
9.2.	Teksti mësimor siguron integrimin e mësimit të shkronjave me tematikat dhe temat e lëndëve mësimore.					
9.3.	Teksti mësimor nxit të nxënit përmes lojës dhe argëtimit (koncepti i shkollës/mësimi “lojë”).					
9.4.	Teksti mësimor u referohet kërkesave të diferencimit në mësim dhe individualizimit (shumësisë dhe ndryshueshmërisë të interesave, moshave-klasave të ndryshme brenda një niveli).					

9.5.	Teksti mësimor paraqet një gjetje e zgjidhje të përshtatshme dhe optimale për punë me klasa të bashkuara (të kombinuara).					
9.6.	Teksti mësimor i referohet realitetit dy- apo shumëgjuhësor dhe dy- apo shumëkulturor, ku favorizohet ndërveprimi gjuhësor e kulturor.					
9.7.	Në raport me shoqërinë, gjuhën, kulturën dhe vlerat e vendit si dhe institucionet e tij, teksti mësimor është i hapur, ndërveprues dhe afirmues.					
9.8.	Teksti mësimor i referohet mjaftueshëm dhe me shembuj konkretë mësimi krahasues dhe ndërveprimeve gjuhësore dhe kulturore.					
9.9.	Si në aspektin e përmbajtjes, ashtu edhe në atë teknik-pamor, teksti mësimor reflekton mesazhe edukative të të qenit krenar për gjuhën, kulturën dhe origjinën.					
9.10.	Teksti mësimor respekton pasurinë dialektore të gjuhës shqipe, i përmbahet gjuhës standarde dhe krijon mundësi që nxënësit ta njohin dhe ta zotërojnë atë.					
9.11.	Teksti mësimor kontribuon në zhvillimin e një kulture të të lexuarit, e cila vazhdon edhe pas shkollës. Për këtë arsye ai përmban materiale, udhëzime, sugjerime dhe nxitje për leximin e mëtejshëm, si p.sh.: pjesë tërheqëse nga librat për fëmijë dhe të rinj, informata e të dhëna bibliografike, udhëzime për përdorimin e bibliotekave dhe të mediave të ndryshme (të shtypura a elektronike), sugjerime për të lexuar gjatë kohës së lirë.					
9.12.	Teksti mësimor përmban udhëzime në lidhje me aspektet teknike të leximit, me strategji të të lexuarit dhe me mënyrat si duhet punuar me lloje të ndryshme tekstesh/shkrimesh të caktuara (p.sh., me poezi, me tekste informative etj.).					

9.13.	Teksti mësimor përmban shkrime/tekste, materiale dhe ushtrime, që përkrahin në mënyrë efektive ndërtimin dhe zhvillimin e aspekteve të veçanta, të pjesshme, të kompetencës letrare, si p.sh.: saktësi, të kuptuarit e përmbajtjes, shpejtësi, rrje-dhshmëri, modelim gjuhësor në lexim me zë të lartë etj.					
9.14.	Teksti mësimor ndihmon në mënyrë efektive ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave gjuhësore në të gjitha fushat e mësimit gjuhësor (lexim, shkrim, të folur, gramatikë, drejtshkrim, të menduarit për gjuhën; ndoshta edhe aspekte në lidhje me media (mjete informimi), për aq sa ato janë objekt i mësimit gjuhësor).					
9.15.	Teksti mësimor kontribuon në mënyrë të kujdesshme dhe sistematike në kultivimin dhe vënien në pah të identitetit individual, kolektiv e kombëtar, nëpërmjet njohjes së trashëgimisë historike e kulturore, lokale, kombëtare, rajonale, evropiane e botërore.					
9.16.	Teksti mësimor respekton veçantitë etnike, kulturore, fetare të shqiptarëve dhe kontribuon në kultivimin dhe vënien në pah të identitetit individual, kolektiv e kombëtar, nëpërmjet njohjes së trashëgimisë historike e kulturore dhe siguron qasje multikulturore e multiperspektive të të parit dhe të prezantuarit të ngjarjeve shoqërore.					
9.17.	Hartat, ilustrimet, fotot, tabelat statistikore të paraqitura në tekstin mësimor nxisin procesin e të kuptuarit, e të analizuarit të ngjarjeve dhe të dukurive historike, gjeografike, kulturore (përfshirë veprat e artit figurativ dhe muzikor), si dhe zhvillojnë të komunikuarit dhe të ndërvepruarit e nxënësve.					
9.18.	Teksti mësimor zhvillon njohjen dhe ndjenjën e dashurisë ndaj vendit të origjinës dhe afirmon njohjen, respektimin dhe hapjen ndaj vlerave të popujve, kombeve dhe kulturave të tjera në Evropë dhe në botë.					

**Vlera e standardit 9 = {[9.1 + - + 9.18] : 18} =**

Në tekstet e nivelit II dhe të nivelit III nuk vlerësohet treguesi 9.2.

#### IV. ASPEKTET PEDAGOGJIKE (STANDARDET 10 – 13)

##### STANDARDI 10: LIDHJA ME REALITETET SHOQËRORE, HISTORIKE DHE POLITIKE

**Synimi:** *Teksti mësimor të lidhet me realitetet shoqërore, historike dhe politike shqiptare, t'i shmanget çdo njëanshmërie dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ndihmojë dhe të nxitë mirëkuptimin dhe tolerancën e ndërsjellë dhe kompetencën ndërkulturore.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
10.1.	Teksti mësimor, në aspektet politike, etnike dhe fetare, nxit tolerancën dhe pluralizmin.					
10.2.	Teksti mësimor pasqyron kontekstet historike të shqiptarëve.					
10.3.	Teksti mësimor nuk i referohet në mënyrë të njëanshme një grupi ose një individi të veçantë dhe përvojave të tij. Teksti mësimor pasqyron realitetin pluralist, duke i shërbyer mirëkuptimit dhe bashkëjetesës së qëndrueshme. Teksti mësimor u referohet shqiptarëve që jetojnë në të gjitha trojet etnike dhe bashkëjetesës me popujt e tjerë.					
10.4.	Në tekstin mësimor, aspektet historike trajtohen në mënyrë të kujdesshme, objektive dhe pa ngarkesa emocionale.					

**Vlera e standardit 10 = {[10.1 + - + 10.4] : 4} =**



## STANDARDI 11: EDUKIMI PËR DEMOKRACI DHE PAQE, KOMPETENCA PERSONALE DHE QYTETARE

**Synimi:** *Teksti mësimor të nxitë zhvillimin e nxënësve si qytetarë të pavarur të cilët i marrin vetë vendimet. Teksti mësimor të ndihmojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, edukimin për demokraci dhe për paqe, duke u orientuar drejt vlerave si toleranca, gatishmëria për bashkëpunim dhe marrja e përgjegjësive, kuraja qytetare, integrimi, respektimi i shumëllojshmërive kulturore, etnike etj. Pyetjet dhe detyrat të nxisin dialogun dhe ndërveprimin midis nxënësve.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
11.1.	Teksti mësimor, nëpërmjet pyetjeve dhe detyrave të përshtatshme, ndihmon në edukimin për demokraci dhe për paqe (aftësi për dialog, gatishmëri për bashkëpunim, shkathtësi komunikimi, tolerancë, altruizëm e solidaritet njerëzor etj.).					
11.2.	Teksti mësimor ndihmon në zhvillimin e kompetencave personale dhe sociale.					
11.3.	Teksti mësimor ndihmon zhvillimin e pavarësisë së nxënësve, nëpërmjet shkrimeve, materialeve, pyetjeve, detyrave etj.					

**Vlera e standardit 11 = {[11.1 + - + 11.3] : 3} =**

## STANDARDI 12: PASQYRIMI I BARAZISË GJINORE

**Synimi:** *Teksti mësimor të kontribuojë në edukimin për barazinë gjinore, të shmangë diskriminimin gjinor. Në shkrime, ilustrime, detyra etj., femrat dhe meshkujt të jenë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe jo sipas stereotipave tradicionalë.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
12.1.	Në shkrimet, ilustrimet, detyrat, pyetjet etj., meshkujt dhe femrat janë përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe po aq shpesh, kur e lejon natyra e temës.					
12.2.	Në shkrimet e ilustrimeve, detyrave, pyetjeve etj., teksti mësimor u referohet në mënyrë të barabartë dhe po aq shpesh përvojave dhe interesave të femrave dhe të meshkujve.					
12.3.	Teksti mësimor u shmanget stereotipave gjinorë, në lidhje me ndarjen e roleve dhe të pamjeve të njëanshme, duke treguar dhe duke paraqitur femra dhe meshkuj në veprimtari dhe kontekste të ndryshme.					
12.4.	Të dyja gjinitë portretizohen, pasqyrohen dhe kanë role në mënyrë të barabartë si në jetën private (në familje), ashtu dhe në të gjitha sferat e jetës shoqërore (në sferën publike, në kontekst historik etj.).					

**Vlera e standardit 12 = {[12.1 + - + 12.4] : 4} =**

## STANDARDI 13: LIDHJA ME ÇËSHTJE TË TJERA PEDAGOGJIKE TË RËNDËSISHME

**Synimi:** *Teksti mësimor të plotësojë kërkesat e edukimit për ruajtjen e mjedisit, edukimit shëndetësor dhe edukimit për media.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
13.1.	Teksti mësimor, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kultivon ndjenjën e dashurisë ndaj mjedisit dhe përgjegjësinë për ruajtjen e tij.					
13.2.	Teksti mësimor, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ndihmon në edukimin shëndetësor (duke bërë objekt aspekte si ushqimi, sporti/ lëvizja, higjiena etj.).					
13.3.	Teksti mësimor, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ndihmon për përdorimin e përshtatshëm të mediave dhe për edukimin e qëndrimit të pavarur ndaj tyre (p.sh., duke nxitur nxënësit të bëjnë hulumtime në internet, të krahasojnë gazeta/ burime të ndryshme etj.).					

**Vlera e standardit 13 = {[13.1 + - + 13.3] : 3} =**

## V. ASPEKTE TË PRAKTIKËS MËSIMORE (STANDARDET 14–15)

### STANDARDI 14: LIBRI I MËSUESIT DHE PËRDORIMI I TIJ

**Synimi:** Në librin për mësuesit: 1. të shtjellohen në mënyrë të kuptueshme dhe të qartë qëllimet, konceptimi didaktik, struktura/ndërtimi, pikat kyçe të tekstit mësimor dhe mënyrat si duhet punuar me të; 2. të paraqiten udhëzime dhe orientime të shkurtra, konkrete për trajtimin e situatave, shkrimeve, materialeve, ushtrimeve etj. të tekstit mësimor. Libri i mësuesit t'i ndihmojë ata që të organizojnë dhe të menaxhojnë procesin e mësimdhënies dhe nxënies me tekstin mësimor.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
14.1.	Libri i mësuesit informon në mënyrë të shkurtër e të qartë për qëllimet, konceptimin didaktik, ndërtimin, pikat kyçe dhe mënyrën si duhet punuar me tekstin mësimor.					
14.2.	Libri i mësuesit jep sugjerime dhe udhëzime konkrete për trajtimin didaktik të secilës temë, nëntemë, faqe, detyrë etj.					
14.3.	Libri i mësuesit përmban udhëzime për planifikimin e mësimit.					
14.4.	Udhëzimet për përdorimin e librit të mësuesit janë të thjeshta dhe të qarta.					

**Vlera e standardit 14 = {[14.1 + - + 14.4] : 4} =**

## STANDARDI 15: MATERIALET QË SHOQËROJNË TEKSTIN MËSIMOR

**Synimi:** *Teksti mësimor të shoqërohet me materiale pune (fletore pune, antologji etj.), që ndihmojnë dhe nxitin përvetësimin dhe përdorimin e njohurive të reja dhe të kompetencave. Materialet e punës mund të jenë: a) të integruara në tekstin mësimor (p.sh., në formën e udhëzimeve, të detyrave dhe të ushtrimeve); b) të veçanta (p.sh., fletore pune që shoqëron tekstin mësimor, CD, harta, linqe të faqeve të internetit etj.). Ato të jenë të larmishme, të shumëllojshme dhe motivuese, të përshtaten për nivele të ndryshme intelektuale të nxënësve.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.1.	Materialet e punës përshtaten dhe plotësojnë tekstin mësimor. Teksti mësimor shoqërohet me mjete dhe referenca të tjera të mjaftueshme mbështetëse multi/hipermediale (CD, DVD, e-learning, software etj.), përfshirë edhe mundësinë e bashkëveprimit me portalet përkatëse aktive virtuale.					
15.2.	Materialet e punës i shërbejnë përpunimit, përvetësimit dhe zbatimit efektiv të përmbajtjes së tekstit mësimor.					
15.3.	Nga ana metodike, materialet e punës janë të larmishme dhe të shumëllojshme. Ato janë të përshtatshme për punën e diferencuar me nxënësit.					
15.4.	Fletoret e punës dhe materialet e tjera plotësuese janë pjesë integrale e tekstit mësimor sipas qasjes së integruar të kurikulës.					

**Vlera e standardit 15 = {[15.1 + - + 15.4] : 4} =**

## FORMULARI PËRMBLEDHËS

<b>Titulli:</b>	<b>Kodi:</b>	
	<b>Data e recensimit:</b>	
<b>Standardi</b>	<b>Vlera</b>	
<b>STANDARDET Sipas Aspekteve</b>		
<b>Përputhshmëria me kurikulën, formatimi, paraqitja (Standardet 1 - 3)</b>		
1.	Përputhshmëria me kurikulën	
2.	Paraqitja dhe qartësia	
3.	Ilustrimet	
<b>Aspektet shkencore dhe didaktike (Standardet 4 - 8)</b>		
4.	Cilësia, rëndësia dhe aktualiteti në pikëpamje përmbajtjesore dhe shkencore	
5.	Përshtatja me moshën e nxënësve	
6.	Konceptimi dhe shtjellimi didaktik	
7.	Pyetjet dhe udhëzimet për detyrat	
8.	Aspektet gjuhësore	
<b>Aspekte të integritit dhe heterogjenitetit (Standardi 9)</b>		
9.	Integrimi dhe heterogjeniteti	
<b>Aspektet pedagogjike (Standardet 10 - 12)</b>		
10.	Lidhja me realitetet shoqërore, historike dhe politike	
11.	Edukimi për demokraci dhe paqe, kompetenca personale dhe qytetare	
12.	Pasqyrimi i barazisë gjinore	
13.	Lidhja me çështje të tjera pedagogjike të rëndësishme	
<b>Aspekte të praktikës mësimore (Standardet 14 - 15)</b>		
14.	Libri i mësuesit dhe përdorshmëria e tij	
15.	Materialet që shoqërojnë tekstin mësimor	
<b>VLERA E TEKSTIT</b>		



**PAKETA E DOKUMENTEVE  
MBI PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË KONKURSIT  
TË TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN**

## **I. QËLLIMI**

1. Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i procedurave dhe kriterëve për zhvillimin e konkursit të teksteve mësimore për diasporën me synimin ruajtjen dhe promovimin e mësimit të gjuhës shqipe, traditave, kulturës dhe historisë shqiptare përmes edukimit të fëmijëve dhe të rinjve në diasporë.
2. Strukturat përgjegjëse për diasporën të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës kanë dakordësuar zhvillimin e konkursit të përbashkët për arritjen e qëllimit të sipërpërmendur.

## **II. PËRSHKRIMI I TEKSTIT MËSIMOR**

1. Hartimi i teksteve mësimore do të realizohet sipas niveleve, përkatësisht Niveli 1, Niveli 2 dhe Niveli 3 duhet të bazohet në:
  - a) “Kurrikulën e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, që bazohet në mësimdhënien e integruar (integrimin e fushave të kurrikulës)
  - b) Standardet e teksteve mësimore të mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë.
2. Tekstet mësimore duhet të jenë kopje fizike dhe përmbajtje digjitale.

## **III. PJESËMARRËS NË KONKURS**

1. Pjesëmarrës në konkursin për tekstet mësimore të përbashkëta për diasporën janë subjekte juridike të llojit “shtëpi botuese” të regjistruara/licencuara dhe të njohura si të tilla përkatësisht konform legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose të Republikës së Kosovës sipas parashikimeve të mëposhtme:
  - a) Shtëpia botuese aplikon në marrëveshje/partneritet me një shtëpi



- tjetër botuese, përveç shtëpive botuese të cilat janë të regjistruara/licencuara në të dyja vendet.
- b) Shtëpia botuese që bën aplikimin për pjesëmarrje në konkurs quhet subjekt aplikues, ndërsa shtëpia botuese që është në partneritet me subjektin aplikues, quhet bashkaplikant.
  - c) Subjekti aplikues që ka selinë në Republikën e Shqipërisë merr pjesë në konkurs në partneritet me bashkaplikantin, i cili ka selinë në Republikën e Kosovës.
  - d) Subjekti aplikues që ka selinë në Republikën e Kosovës merr pjesë në konkurs në partneritet me bashkaplikantin i cili ka selinë në Republikën e Shqipërisë.
  - e) Partneriteti midis subjektit aplikues dhe bashkaplikantit vërtetohet përmes një marrëveshjeje paraprake të lidhur mes tyre apo kontrate të përkohshme të bashkëpunimit lidhur para një noteri publik.
  - f) Subjekti aplikues dhe ai bashkaplikant duhet të përmbushin njëherazi kriteret ligjore të ushtrimit të veprimtarisë në përputhje me legjislacionin e vendit respektiv.
  - g) Mospërmbushja e kriterëve ligjore nga subjekti aplikues dhe/ose bashkaplikanti, sjell skualifikimin në konkurs.
  - h) Nëse subjekti aplikues shpallet fitues në konkurs, subjekti bashkaplikant do të bëhet përfitues së bashku me subjektin aplikues.
2. Shtëpitë botuese duhet të kontraktojnë autorë të fushave përkatëse sipas kurrikulës së mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë.
  3. Administratori (pronari)/përfaqësuesi ligjor të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe ndaj tij të mos jetë nisur një hetim penal.
  4. Shtëpia botuese të ketë përmbushur të gjitha detyrimet ligjore për shlyerjen e tatimeve apo taksave.

#### **IV. AFATET E KONKURSIT**

1. Komisioni i Përbashkët i Miratimit të Teksteve Mësimore për Diasporën (në vijim Komisioni) vendos shpalljen e thirrjes për aplikim.
2. Strukturat përkatëse qeveritare të secilit shtet, përkatësisht Ministri i Shtetit për Diasporën në Shqipëri dhe Ministria e Arsimit në Republikën e Kosovës publikojnë thirrjen për aplikim në faqet zyrtare respektive.
3. Thirrja për aplikim përmban:
  - a) titullin e tekstit mësimor për të cilin zhvillohet konkursi;
  - b) datat konkrete të dorëzimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik nga ana e subjektit aplikues;
  - c) vendin e kryerjes dhe depozitimit të dokumentacionit nga ana e subjektit aplikues.
4. Komisioni përcakton afatin përkatës, sipas niveleve, se sa kohë nga shpallja konkursi do të jetë i hapur.
5. Afati i aplikimit do të jetë 3 ditë pune pas përfundimit të afatit të vendosur për konkurs (3 ditë pune në Prishtinë dhe 3 ditë pune në Tiranë).
6. Pranimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të shtëpive botuese bëhet nga Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën (më poshtë Komisioni) bëhet nga Komisioni.
7. Në ditën e aplikimit, subjekti aplikues depoziton dokumentacionin ligjor dhe teknik të kërkuar.
8. Në rast se dokumentacioni ligjor dhe teknik i subjektit aplikues është i plotë, Komisioni pranon tekstet mësimore për konkurs.
9. Anëtarët e Komisionit dhe sekretaria teknike në funksion të tij, duhet të nënshkruajnë deklaratën për pajtueshmërinë me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave, sipas shtojcës 7 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.

#### **V. DOKUMENTACIONI LIGJOR I NEVOJSHËM PËR KONKURS**

1. Subjekti aplikues duhet të paraqesë dokumentacion ligjor të mëposhtëm:

- a) Marrëveshjen e partneritetit me bashkaplikantin. apo kontratën e përkohshme të bashkëpunimit lidhur para një noteri publik.
  - b) Dokumentin për regjistrimin si person juridik, me të drejtë ushtrimi aktiviteti si botues.
  - c) Certifikatën e regjistrimit në organet tatimore për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.
  - d) Dokumentin që vërteton se në ngarkim të subjektit/ administratorit (pronarit) nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.
  - e) Dokument lëshuar nga organi kompetent lidhur me gjendjen gjyqësore.
  - f) Vërtetimin nga strukturat e tatimeve dhe e taksave për shlyerjen e detyrimeve përkatëse.
2. Subjekti aplikues paraqet dokumentacionin e parashikuar në pikën 1 të këtij kreu, edhe për bashkaplikantin.
  3. Dokumentet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, të jenë të lëshuara nga institucionet e vendeve përkatëse, jo më vonë se tri muaj nga data e aplikimit të subjektit aplikues.
  4. Dokumentacioni i mësipërm shqyrtohet nga Komisioni dhe dokumentohet me procesverbal.
  5. Mungesa ose pasaktësia, qoftë dhe e njërit prej dokumentacionit ligjor, sjell mospranimin në vlerësim të subjektit aplikues.

## **VI. DOKUMENTACIONI TEKNIK I NEVOJSHËM PËR KONKURS**

1. Subjekti aplikues duhet të paraqesë dokumentacion teknik të mëposhtëm:
  - a) Deklaratën e botuesit për pajtueshmërinë me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.
  - b) Deklaratën për të drejtën e botimit mbi origjinalitetin e tekstit mësimor në tërësi dhe të pjesëve të veçanta të saj, si dhe kopje të akteve ose të marrëveshjeve që mund të jenë bërë për aplikimin,

- për marrjen e lejes ose blerjen e elementeve të veçanta të së drejtës së autorit nga të tretët, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.
- c) Deklaratën për autorësinë e tekstit, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.
  - d) Deklaratën për çmimin e shitjes të tekstit mësimor, sipas shtojcës 4 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.
  - e) Të dhëna për grupin hartues/realizues të tekstit mësimor, sipas shtojcës 5 bashkëlidhur kësaj pakete dokumentesh.
2. Dokumentacioni teknik që dorëzohet për tekstin mësimor duhet të jetë original ose kopje e noterizuar.
  3. Dokumentacioni teknik i mësipërm, për tekstin mësimor duhet të dorëzohet në zarf të bardhë të formatit A4, të mbyllur dhe të dyllësuar, pa shenja të jashtme dalluese që mund të zbulojnë përkatësinë e zarfit.
  4. Në momentin e aplikimit, subjekti aplikues dorëzon në një zarf të mbyllur:
    - a) çmimin e propozuar të shitjes së tekstit mësimor për njësi.
    - b) vetëdeklarimin për përmbushjen e kriterëve teknike të tekstit mësimor, sipas shtojcës bashkëlidhur nr. 6.
  5. Dokumentacioni teknik shqyrtohet nga Komisioni dhe dokumentohet me procesverbal.
  6. Mungesa ose pasaktësia, qoftë dhe e njërit prej dokumentacionit teknik, sjell mospranimin në vlerësim të subjektit aplikues.
  7. Në rast se dokumentacioni ligjor dhe teknik i subjektit aplikues është i plotë dhe në përmbushje të parashikimeve të mësipërme të pikës 5, Komisioni pranon tekstet mësimore në konkurs.

## **VII. PRANIMI I TEKSTEVE MËSIMORE NË KONKURS**

1. Kriteret për pranimin e teksteve mësimore në konkurs janë si vijon:
  - a) Subjekti të dorëzojë për konkurs 9 (nëntë) kopje fizike të titullit të tekstit mësimor të shoqëruara me CD (përmbajtje digjitale).
  - b) Çdo kopje e tekstit mësimor të jetë e radhitur, e faqosur dhe e shtypur

me letrën dhe në formatin siç parashikohet të dalë nga shtypi.

- c) Çdo kopje të jetë e lidhur me vrima e me kapëse plastike me ngjyrë të zezë; të mos ketë kopertinë e frontespice; faqet të mos përmbajnë elemente që mund të identifikojnë përkatësinë e tekstit mësimor.
  - d) Asnjë prej kopjeve të tekstit mësimor të paraqitura për konkurs të mos përmbajë shenjat e zakonshme të identifikimit që i ka teksti kur është i gatshëm për përdorim, si: autorët, emrin apo logon e shtëpisë botuese etj.
  - e) Në çdo kopje të tekstit mësimor që do të dorëzohet, titulli i tij të shkruhet sipas emërimit të përcaktuar nga Komisioni. Ai të shkruhet me ngjyrë të zezë, me germa të mëdha shtypi, tip “Bookman Old Style”, bold, me madhësi 36-she. Në rast moszbatimi të kësaj kërkesë, teksti mësimor nuk pranohet për konkurs.
  - f) Numrat rendorë të faqeve të jenë të shkruar në anën e djathtë, poshtë, të çdo faqeje, në tipin e germave të vogla “Bookman Old Style”, me madhësi 12-she, me ngjyrë të zezë, jo bold.
  - g) Kopjet e tekstit mësimor të paraqiten pa kopertina dhe frontespice; si kopertinë, në formatin e bllokut, t’u ngjitet letër e bardhe 80 g/m<sup>2</sup>, ku titulli të shkruhet sipas përcaktimit të bërë në shkronjën e, më lart.
2. Në rast pranimi të dokumentacionit ligjor, dokumentacionit të tekstit mësimor për konkurs, komisioni i jep subjektit aplikues një nga dy kopjet e formularit për marrjen në dorëzim. Dokumentacioni ligjor dhe teknik, kopjet e dokumentacionit të tekstit mësimor në asnjë rast dhe për asnjë arsye, nuk i kthehen subjektit aplikues.

## **VIII. KRITERE MBI PËRMBAJTJEN DIGJITALE**

1. Përmbajtja digjitale duhet të jetë në përputhje me tekstin mësimor dhe me standardet e teksteve mësimore për diasporën, të miratuara nga Komisioni.
2. Përmbajtja digjitale duhet të realizojë 4 qëllimet kryesore:
  - a) Qasjen për t’u përdorur lehtësisht nga të gjithë nxënësit;
  - b) Lehtësinë me të cilën përmbajtja digjitale mbartet nga një hardware

- ose mjedis software, në tjetrin;
- c) Lehtësinë me të cilën përdoruesit mund të punojnë me të dhe të arrijnë rezultatet e përcaktuara në kurrikulën e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diaspoër dhe mërgatë;
  - d) Mundësinë që përmbajtja digjitale të jetë e përshtatshme për t'u përdorur në mënyrë të pavarur dhe të përshtatet në kontekste të tjera.
3. Kriteret që duhet të plotësojë çdo përmbajtje digjitale mësimore, që do të paraqitet në këtë konkurs, janë:
- a) Të integrojë funksionet: mësimdhënie, mësimnxënie dhe interaktivitet mësues-nxënës.
  - b) Të ketë fleksibilitet për çdo format përdorimi në grup ose individualisht, si në mësimin në klasë ashtu dhe në distancë.
  - c) Të funksionojë 100% në çdo pajisje elektronike me sistem operativ Android, MICROSOFT dhe IOS.
  - d) Të mundësojë përditësimin teknik dhe përmbajtësor, pa penguar ecurinë funksionale të përdorimit.
  - e) Të mundësojë lehtësisht qasje (akses), në mënyrë që të sigurojë cilësinë e mësimdhënies.
4. Përmbajtja digjitale duhet të jetë e ndërveprueshme dhe të sigurojë:
- a) Funksionalitetin e videove, audiove, animacioneve ose materialeve të tjera shtesë, edhe në rastet kur përdoruesi nuk ka lidhje në internet.
  - b) Qasje të lehtë të përdoruesit të fundit (nxënës dhe mësues, prindër etj.).
5. Përmbajtja digjitale nuk duhet të jetë e kufizuar në: hyperlinks, navigacion, elementet dhe modifikimet e përdoruesit.
6. Komponentët e përmbajtjes mund të përsëriten apo të përditësohen në tërësinë e tyre ose në pjesë të veçanta, si p.sh., testimet, simulimet, tema, diskutimet etj.).
7. Përmbajtja mësimore organizohet në dosje/file të veçanta që korrespondojnë me tematikat dhe rezultatet e të nxënës sipas tekstit mësimor fizik.

8. Përmbajtja digjitale të shoqërohet me udhëzues për përdorimin nga mësuesit që do të punojnë me këto përmbajtje.

## **IX. VLERËSIMI I TEKSTEVE MËSIMORE NË KONKURS**

1. Vlerësimi i tekstit mësimor në konkurs realizohet në dy faza.
  - a) Në fazën e parë realizohet vlerësimi i teksteve mësimore në dorëshkrim në aspektin përmbajtësor.
  - b) Në fazën e dytë vlerësimi realizohet përmes çmimit të ofruar nga subjekti aplikues.
2. Vlerësimi i teksteve mësimore në konkurs në fazën e parë realizohet sipas parashikimeve si vijon:
  - a) Vlerësimi i tekstit mësimor në konkurs bëhet nga recensuesit.
  - b) Vlerësimi i tekstit mësimor në konkurs bëhet nga 9 recensues, prej të cilëve 6 janë specialistë sipas fushave të parapara në kurrikulën e përbashkët, një specialist gjuhësor dhe dy mësues nga diaspora.
  - c) Teksti mësimor vlerësohet nëse është në përputhje me standardet e përmbajtjes.
  - d) Recensuesit vlerësojnë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.
  - e) Përveç pikëzimit, recensuesit shkruajnë edhe një raport të argumentuar për vlerësimin e bërë.
  - f) Recensuesit duhet të nënshkruajnë deklaratën për pajtueshmërinë me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave, sipas shtojcës 8 bashkëlidhur kësaj pakete.
3. Komisioni, mbi bazën e vlerësimeve të recensuesve:
  - a) Përlllogarit pikët e grumbulluara për çdo tekst mësimor në konkurs, duke nxjerrë vlerën mesatare të pikëve sipas standardeve për secilin tekst mësimor në dorëshkrim.
  - b) Shpall listën paraprake të teksteve mësimore në konkurs që kanë plotësuar vlerën mesatare të standardeve dhe i rendit sipas pikëve.
4. Në fazën e dytë realizohet vlerësimi i teksteve mësimore në konkurs, në

lidhje me çmimin e propozuar nga subjekti aplikues.

5. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të përmbajtjes së teksteve mësimore në konkurs, Komisioni në prani të subjekteve aplikues, bën hapjen e zarfeve ku ndodhen edhe formularët përkatës të çmimeve të shitjes të propozuara për njësi, nga çdo subjekt aplikues. Një kopje e procesverbalit të hapjes të vihet në dispozicion të subjekteve aplikuese.
6. Komisioni përcakton çmimin mesatar aritmetik (çmimin tavan), i cili përlllogaritet si shumatore e çmimeve të propozuara nga subjektet aplikuese pjesëtuar me numrin e teksteve mësimore në konkurs të dorëzuara. Çmimi tavan të aplikohet për ato tekste mësimore në konkurs, për të cilat çmimi i propozuar nga subjekti aplikues e tejkalon çmimin tavan, ndërsa për tekstet e ofruara me çmim poshtë çmimit tavan, si çmim i shitjes të vendoset ai i propozuar nga subjekti aplikues.
7. Në rast se dy tekste mësimore në konkurs kanë pikë të barabarta, përzgjidhet teksti me çmim më të ulët.

#### **X. SHPALLJA PËRFUNDIMTARE E LISTËS SË TEKSTEVE MËSIMORE**

1. Komisioni i dërgon për miratim ministrave përgjegjës të të dy vendeve listën e renditjes së teksteve mësimore.
2. Komisioni i propozon ministrave përgjegjës të të dy vendeve si tekst fitues, tekstin mësimor të renditur të parin.
3. Vendimin për miratimin e tekstit mësimor fitues e marrin ministrat përgjegjës të të dy vendeve.
4. Teksti mësimor në konkurs i renditur i pari është teksti që do të përdoret për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë nga Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës. Në rast se shtëpia botuese e këtij teksti nuk i përmbush detyrimet e botimit, të kërkuara nga ministritë përgjegjëse, për shpërndarjen e teksteve mësimore në diasporë të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, atëherë do të përdoret teksti i renditur i dyti, e kështu me radhë në vijim.



## **XI. ANKIMIMI PËR VENDIMIN/URDHRIN E MINISTRAVE PËRGJEGJËS**

1. Çdo subjekt aplikues që është i pakënaqur me aktin administrativ të ministrive përgjegjëse të të dy vendeve ka fillimisht të drejtën e ankimit përmes rrugës administrative, sipas afateve e procedurave si më poshtë:
  - a) Subjekti aplikues ka të drejtën e ankimit administrativ brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja në dijeni, por jo më shumë se 15 ditë pune nga marrja e vendimit. Ankimi administrativ paraqitet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit aplikues.
  - b) Ankimi administrativ depozitohet me shkrim dhe në të përshkruhet interesi i ligjshëm lidhur me procesin e zhvillimit të konkursit.
  - c) Ankimi administrativ bëhet në vendin ku është bërë aplikimi. Në Republikën e Kosovës ankimi administrativ paraqitet në Komisionin e Ankesave, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, ndërsa në Republikën e Shqipërisë ankimi administrativ paraqitet në Komisionin e ngritur nga Qendra e Botimeve për Diasporën.
  - d) Komisionet e shqyrtimit të ankimit administrativ duhet t'i shqyrtojnë ato në afatin kohor prej 30 ditëve.
2. Ndaj vendimit administrativ të Komisioneve respektive, subjekti aplikues i pakënaqur ka të drejtën e parashtrimit të padisë në gjykatën kompetente të vendit përkatës.

## **XII. DETYRIMET E SUBJEKTEVE APLIKUESE**

1. Subjekti aplikues merr përsipër dhe mban përgjegjësi për marrëdhëniet e tij me autorët e teksteve, për përgatitjen për shtyp të origjinaleve të teksteve, për zbatimin e kërkesë/porosive për tekste nga ministritë përgjegjëse të të dy vendeve për porositjen dhe shpërndarjen e teksteve mësimore në diasporë.
2. Subjekti aplikues, në kopertinën e çdo kopjeje të tekstit mësimor, shënon të gjitha elementet sipas legjislacionit në fuqi të të dy vendeve.

### **XIII. DISPOZITAT E FUNDIT**

Dokumentacioni ligjor lidhur me procesin e konkursit, miratimit, porositjes, shpërndarjes së teksteve mësimore (aktet, programet mësimore, standardet e teksteve mësimore etj.), si dhe çdo material tjetër shpjegues për të interesuarit, të publikohen në faqen zyrtare të ministrive përgjegjëse të të dy vendeve për zbatimin e kësaj pakete dokumentesh.

**SHTOJCA 1:**

**DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E  
KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Deklaroj se asnjë prej ekipit hartues të tekstit mësimor, të përfshirë në shtojcat 3 dhe 6, të tekstit mësimor për diasporën me titull: \_\_\_\_\_, dorëzuar për konkurs pranë Komisionit të Përbashkët të Miratimit të Teksteve Mësimore për Diasporën, nuk ka interesa familjare ose financiare me ndonjë anëtar të tij ose të sekretarisë teknike të këtij komisioni.

Deklaroj po ashtu, se unë nënshkruesi i kësaj deklarate nuk jam i lidhur me interesa familjare ose financiare me anëtarë të komisionit dhe të sekretarisë së përmendur më lart.

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 202 \_\_\_\_

PËR BOTUESIN

\_\_\_\_\_  
(emri zyrtar i subjektit aplikues)

\_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, firma, vula)

## SHTOJCA 2:

### DEKLARATA PËR TË DREJTËN E BOTIMIT

Deklaroj “Të drejtën e botimit” të tekstit mësimor për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë, me titullin: \_\_\_\_\_ ||| \_\_\_\_\_ dorëzuar për vlerësim në Komisionin e Përbashkët të Miratimit të Teksteve Mësimore për Diasporën:

Nr.	Pjesa e tekstit ose teksti në tërësi	Zotëruesi	Burimi

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 202\_\_

PËR BOTUESIN

\_\_\_\_\_  
(emri zyrtar i subjektit)

\_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, firma, vula)

#### **Shënim për plotësimin e formularit:**

*Si pjesë e tekstit mësimor për diasporën, për efekt të burimit të së drejtës së botimit, mund të përfshihen edhe ilustrime, ide ose punë editoriale. Zotërimi i kësaj të drejte nga subjekti përkatës duhet të dëshmohet në kontratën përkatëse të lidhur mes autorit/ëve dhe botuesit ose me dokumente të blerjes apo dhurimit të kësaj të drejte nga të tretë, kopje të noterizuara të të cilave i bashkëlidhen kësaj deklaratë. Në rastet kur e drejta e botimit është fryt i punës origjinale të vetë subjektit, në kolonën e tretë për burimin e të drejtës së botimit shënohet “Punë origjinale”. Në kolonën e burimit të së drejtës së*

botimit shënohet, sipas rastit: “Originale” ose “Nga të tretë” (shënohet në kllapa pala e tretë dhe përfshihet dokumenti i blerjes apo dhurimit).

### SHTOJCA 3:

#### DEKLARATA PËR AUTORËSINË E TEKSTIT MËSIMOR PËR DIASPORËN

Deklaroj se autori/ët e tekstit mësimor për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë, me titullin: \_\_\_\_\_, dorëzuar për konkurs në Komisionin e Përbashkët të Miratimit të Teksteve Mësimore për Diasporën, janë:

Emri dhe mbiemri	Pjesa e tekstit (kapitujt ose thjesht bashkautorësi)

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 202\_\_

PËR BOTUESIN

\_\_\_\_\_

(emri zyrtar i subjektit)

\_\_\_\_\_

(emri, mbiemri, firma, vula)

**SHTOJCA 4:**

**DEKLARATA PËR ÇMIMIN E SHITJES PËR  
NJËSI TË TEKSTIT MËSIMOR PËR DIASPORËN**

Deklaroj se çmimi i shitjes për njësi të tekstit mësimor për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë, me titullin: \_\_\_\_\_: \_\_\_\_\_, dorëzuar për vlerësim në Komisionin e Përbashkët të Miratimit të Teksteve Mësimore për Diasporën, është:

\_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_) lekë/euro.

(me shifra)

(me shkrim)

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 202\_\_

PËR BOTUESIN

\_\_\_\_\_  
(emri zyrtar i subjektit)

\_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, firma, vula)

**SHTOJCA 5:**

**TË DHËNA PËR EKIPIN HARTUES/REALIZUES TË TEKSTIT MËSIMOR  
PËR MËSIMIN PLOTËSUES TË GJUHËS SHQIPE DHE KULTURËS  
SHQIPTARE NË DIASPORË DHE NË MËRGATË,  
ME TITULLIN: \_\_\_\_\_**

<b>Autorësia</b>	<b>Po</b>	<b>Jo</b>
Autor i vetëm, pedagog/profesor universiteti/me gradë shkencore		
Autor i vetëm, mësues/mësimdhënës		
Dy ose më shumë pedagogë/ profesor universiteti/me gradë shkencore		
Dy ose më shumë mësues/mësimdhënës		
Pedagog/profesor universiteti/me gradë shkencore dhe mësues/mësimdhënës		
Më shumë se dy pedagogë/ profesor universiteti/me gradë shkencore dhe mësues/mësimdhënës		

Përvoja pedagogjike:

-Mësues/mësimdhënës \_\_\_\_vjet

-Pedagog \_\_\_\_vjet

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 202\_\_

Shënim për plotësimin e formularit: Të dhënat përkatëse të pasqyrohen brenda kutisë duke përdorur simbolin “X”

1. Redaktorët shkencorë:

a) Redaktori i parë \_\_\_\_\_

Institucione arsimore e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi

b) Redaktori i dytë (në qoftë se ka) \_\_\_\_\_

Institucione arsimore e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi :

## 2. Redaktorët gjuhësor:

a) Redaktori i parë \_\_\_\_\_

Institucione arsimore e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

b) Redaktori i dytë (në qoftë se ka) \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Institucione arsimore e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 202\_\_

Shënim: Deklarata plotësohet nga botuesi për cdo anëtar të ekipit realizues për tekstin mësimor për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë, me titullin: \_\_\_\_\_

PËR BOTUESIN

\_\_\_\_\_

(emri zyrtar i subjektit)

\_\_\_\_\_

(emri, mbiemri, firma, vula)



## SHTOJCA 6:

### DEKLARIMI PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TEKNIKE TË TEKSTIT MËSIMOR PËR MËSIMIN PLOTËSUES TË GJUHËS SHQIPE DHE KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË DHE NË MËRGATË, ME TITULLIN: \_\_\_\_\_

NR	ELEMENTET E TEKSTIT MËSIMOR	KRITERET	PO	JO
1	Organizimi i përmbajtjes së tekstit	Përmbajtja e tekstit paraqitet në një vëllim.		
2	Formati i prerë i tekstit	207 mm gjatësi x 277 mm gjerësi		
3	Madhësia e germave	Shkronja me font mbi 12		
4	Hapësira mes rreshtave	Hapësira mes rreshtave: 120% e shkronjave		
5	Lloji i letrës për tekstin mësimor dhe të fletores e punës	Asnjë lloj letre me lustër		
		Opaciteti 80 përqind (ISO 2471)		
		Shkëlqimi 83 përqind (ISO 2470)		
		Pesha e letrës së librit 70 gsm		
6	Lloji i letrës për kopertinën	Për libra deri 96 faqe 200 gsm		
		Për libra mbi 96 faqe 280 gsm		
7	Ngjyrat për tekstin mësimor dhe fletoren e punës	Libri i nxënësit 4 ngjyra		
		Fletore pune 4 ngjyra		
	Ngjyra për kopertinat	Kopertinat 4 ngjyra		
8	Lloji i lidhjes	Deri 96 faqe Me tel kaluar; 2 kapje		
		Mbi 96 faqe Ngjitje me hotmelt		
9	Elemente të detyrueshme të kopertinave	ISBN-ja		
		Barkod-i		
		Çmimi		
		Logo-ja e botuesit		

#### Sa i përket kompozimit të përmbajtjeve të tekstit mësimor, rekomandohet:

- Teksti të organizohet sipas kapitujve që fillojnë me faqen hyrëse ku gjenden përmbajtja e shkurtër, fjalët kyç dhe përmbledhja e kapitullit.
- Të gjitha temat e kapitujve të fillojnë në faqe të re.
- Në faqet e tekstit, përveç shkrimeve themelore, mund të vendosen tabela, ilustrime, fragmente etj. Pozicioni i tyre, në aspektin pamor, të mos dëmtojë tërësinë e tekstit; sipas mundësisë, të pozicionohen në skajet e jashtëm të faqes.
- Për të gjithë titujt, të përdoret font i njëjtë si nga madhësia dhe nga lloji.
- Ilustrimet (hartat, tabela, grafikë etj.), të jenë lehtësisht të përdorshme dhe teksti të ketë font me madhësi të lexueshme.

## **SHTOJCA 7:**

### **DEKLARATË E ANËTARIT TË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT TË MIRATIMIT TË TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN DHE SEKRETARISË TEKNIKE TË TIJ PËR PAJTIMIN ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

#### **DEKLARATË**

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, anëtar i Komisionit të Përbashkët të Miratimit të Teksteve Mësimore për Diasporën/sekretari i këtij Komisioni, deklaroj nën përgjegjësinë dhe vullnetin tim të plotë se nuk kam konflikt interesi të asnjë lloji për të marrë pjesë në konkurs për tekstet mësimore për diasporën.

Në mënyrë të veçantë pohoj, se:

- Nuk jam pjesë e ekipit realizues në asnjë prej teksteve mësimore për diasporën , të dorëzuara për konkurs në Komisionin e Përbashkët të Miratimit të Teksteve Mësimore për Diasporën.
- Nuk kam lidhje familjare dhe financiare me pronarë të shtëpive botuese që marrin pjesë në procesin e prodhimit të teksteve mësimore për diasporën, të dorëzuara për konkurs në Komisionin e Përbashkët të Miratimit të Teksteve Mësimore për Diasporën.

#### **DEKLARUESI**

\_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, nënshkrimi)

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_ 202\_\_

**SHTOJCA 8:**

**DEKLARATË E RECENSUESIT PËR PAJTIMIN ME LIGJIN PËR  
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

**DEKLARATË**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me të dhënat e mëposhtme deklaroj nën përgjegjësinë dhe vullnetin tim të plotë se nuk kam konflikt interesi të asnjë lloji për të marrë pjesë në vlerësimin e teksteve mësimore për diasporën.

Në mënyrë të veçantë pohoj, se:

- Nuk jam pjesë e ekipit realizues në asnjë prej teksteve mësimore për diasporën , të dorëzuara për konkurs në Komisionin e Përbashkët të Miratimit të Teksteve Mësimore për Diasporën.
- Nuk kam lidhje familjare dhe financiare me pronarë të shtëpive botuese që marrin pjesë në procesin e prodhimit të teksteve mësimore për diasporën, të dorëzuara për konkurs në Komisionin e Përbashkët të Miratimit të Teksteve Mësimore për Diasporën.

**DEKLARUESI**

\_\_\_\_\_  
emri, mbiemri, nënshkrimi)

\_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Telefon /celular: \_\_\_\_\_

E mail \_\_\_\_\_

Rruga \_\_\_\_\_ Lagjja \_\_\_\_\_ Bashkia/komuna \_\_\_\_\_

Emri i bankës \_\_\_\_\_

IBAN \_\_\_\_\_ SWIFT CODE \_\_\_\_\_

Nr. i llogarisë \_\_\_\_\_.

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 202\_\_\_\_



## **KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E RECENSUESVE**



Recensent është specialisti/eksperti i zgjedhur nga Komisioni, përgjegjës për vlerësimin kritik dhe profesional të tekstit mësimor në dorëshkrim.

Vlerësimi i tekstit mësimor në dorëshkrim bëhet nga 9 recensentë, prej të cilëve 6 janë specialistë sipas fushave përcaktuara në kurrikulën e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë, një specialist gjuhësor dhe dy mësues nga diaspora.

➤ **Specialistët/ekspertët sipas fushave janë specialistë në:**

1. Gjuhë shqipe,
2. Letërsi shqipe,
3. Histori,
4. Gjeografi,
5. Kulturë muzikore,
6. Kulturë figurative.

➤ **Një specialist gjuhësor.**

➤ **Dy mësues nga diaspora.**

**Kriteret për përzgjedhjen e recensentëve:**

*Specialist/eksperti sipas fushave:*

- Të jetë i diplomuar, së paku me ciklin e dytë të studimeve dhe të ketë gradë shkencore, në fushat përkatëse (gjuhë shqipe, letërsi, histori, gjeografi, kulturë muzikore, kulturë figurative).
- Të ketë kontribute në fushën përkatëse (botime, konferenca).
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë në vlerësimin e teksteve mësimore.

➤ *Për specialistin/ ekspertin gjuhësor:*

- Të jetë diplomuar, së paku me ciklin e dytë të studimeve në Gjuhë shqipe.
- Të ketë përvojë në redaktimin gjuhësor në fushën e botimeve.

➤ *Për mësuesit nga diaspora:*

- Të jenë të diplomuar si mësues/mësimdhënës për ciklin fillor/klasor ose në njërin nga fushat e kurrikulës së mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë (gjuhë shqipe, letërsi, histori, gjeografi, kulturë muzikore, kulturë figurative).
- Të jetë mësues në diasporë.
- Të ketë përvojë pune së paku 5-vjeçare si mësues i gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.
- Të ketë kualifikime dhe trajnime në fushën e mësimdhënies.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dëshmitë (dokumentet) mbi bazën e kritereve të përcaktuara më lart.